

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË

Adresa: Bulevradë Fan S. Noli, Korçë
Nr.1/2

Tel/Fax: +355(0)82243366
Në Korçë sot më dt. 05.11.2020

Lënda: Kërkesë për për njohjen e vendimit të Gjykatës së Përbërë me Be Karditsa.

Drejtuar: Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Më datën 16.10.2020 në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë është dërguar kërkesa e autoriteteve greke të drejtësisë me objekt njohjen e vendimit të Gjykatës së Përzierë të Betuar të Lamias nr.52-55/2-12-2015 ndaj shtetasës shqiptare Irena Kostaki, e bija e Vangjel dhe Elefteria, dtl.29.12.1973, lindur në fshatin Miras, Devoll dhe banues në fshatin Miras, Nj.A. Miras, ndërtesa 312, Bashkia Devoll, identifikuar nga NID H36229102N.

Nga aktet bashkëngjitur kësaj kërkesë rezulton se:

Shtetasja Irena Kostaki në gjendje të qetë psikologjike ka vrarë duke e mbytur me duar vajzën e saj 9 muajshe Ioanna Kostaki. Për këtë fakt Gjykata e Përzierë e Betuar e Lamias me vendimin e saj nr.52-55/2-12-2015 ka dënuar shtetasen shqiptare Irena Kostaki për veprën penale të “vrasja me qëllim”(vepër penale që parashikohet nga legjislacioni grek nga nenet 1, 299 te Kodit Penal).

Kjo Gjykatë e ka dënuar këtë shtetase me me 20 vjet burgim për veprën penale të mësipërme.

Vendimi i Gjykatës së Përzierë të Betuar të Lamias me nr.52-55/2-12-2015 ka marrë formë të prerë nuke mos u ankimuar, fakt që provohet me vërtetimi zyrtar me nr.15/8-1-2020 i Gjykatës së Shkallës së Parë Lamia.

E dënuara ishte që nga data 28.08.1996 me masë sigurie në Qendrën e Paraburgimit të Femrave Korydallou, por ajo është arratisur nga ky burg në datën 05.03.1997, duke e bërë të pamundur ekzekutimin e vendimit nr.52-55/2-12-2015 të Gjykatës së Përzierë të Betuar të Lamias.

Vepra penale për të cilën ajo është dënuar në Greqi njihet dhe është e dënueshme edhe nga ligji ynë penal. Konkretisht: vrasja me qëllim(vepër penale që parashikohet nga legjislacioni grek nga nenet 1, 299 te Kodit Penal), parashikohet si krim nga neni 78/1 i Kodit Penal dhe dënohet me burgim nga nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.

Për sa më sipër vendimi i gjykatës së huaj duhet të njihet pasi:

a) vendimi ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë;

b) vendimi nuk përmban disponime në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar;

c) vendimi është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe i pandehuri është thirrur të paraqitet në gjykim dhe i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës;

ç) nuk ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike;

d) fakti për të cilin është dhënë vendimi parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar;

dh) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar nuk është dhënë një vendim i formë së prerë ose zhvillohet një procedim penal.

Me shkresën 2401/1 prot., dt.16.10.2020 Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, i ka dërguar aktet Prokurorisë së Përgjithshme duke kërkuar njohjen e vendimit penal të mësipërm.

Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme i është kërkuar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, fillimisht njohja e vendimit të huaj e më pas vazhdimi i procedurave për ekzekutimin e këtij dënimi në Shqipëri.

Për sa më sipër bazuar në nenin 512/3 të Kodit të Procedurës Penale, i parashtroj gjykatës këtë:

Kërkesë

Njohjen e vendimit me nr.52-55/2-12-2015 të Gjykatës së Përzierë të Betuar të Lamias të dhënë ndaj shtetases shqiptare Irena Kostaki, e bija e Vangjel dhe Elefteria, dtl.29.12.1973, lindur në fshatin Miras, Devoll dhe banues në fshatin Miras, Nj.A. Miras, ndërtesa 312, Bashkia Devoll, identifikuar nga NID H36229102N.

Kësaj kërkesë iu bashkua e gjithë praktika e ardhur nga autoritetet greke, si dhe shkresat përcjellëse: shkresa e Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë me 2401/1 prot., dt.16.10.2020; shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme me nr.1295/5, dt.20.10.2020.